

Pyetjet dhe përgjigjet nga Takimi Orientues (*webinar*), i zhvilluar më 19 Maj, ora 10:00, si pjesë e thirrjes së dytë për projekt propozime nga projekti ideAL

1. A mund të arrihet ndryshimi i një politike lokale apo qendrore me përfshirje e grupeve të interesit dhe aktorëve politikë (institucioneve) për të hartuar/ndryshuar një politikë?

Ju si grup interesi duhet të keni në fokus dialogun me aktorë të caktuar për të ndikuar në politikbërje dhe jo asistencën teknike të tyre. Në rast se mungon një dokument ose është i paplotë (i mungon një kapitull ose nuk trajton një aspekt të caktuar i cili duhet të jetë pjesë e tij), grupi i interesit mund të hartojë këto elementë që mungojnë në dokumentin politik dhe më pas të dialogojë me institucionin që ka për detyrë të miratojë dhe adoptojë këtë politikë të hartuar ose përmes negociimit të përshtatni atë. Në rast se ju shpreheni se institucioni nuk ka kapacitete për të adoptuar këtë politikë, projekti juaj mbetet në kuadrin e asistencës teknike dhe është vetëm projekt zhvillim. Thirrja nuk ka për qëllim asistencën teknike apo ngritjen e kapaciteteve sepse këto rezultate duhet të jenë indirekte ndërsa influencimi i një politike duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë.

2. A mund që një iniciativë për ndryshim politikash të shtrihet edhe në nivel rajonal të shkojë përtej kufirit (cross-border)?

Në pikën 2.1.3 shpjegohet lejueshmëria e kostove, kjo thirrje parashikon që të gjitha aktivitetet të zhvillohen në Shqipëri. Kjo do të thotë se nisma, objektivi, fokusi dhe rezultatet e projektit tuaj duhet të jenë të bazuara në kontekstin shqiptar dhe në ndikimin e politikave tërësisht në nivel lokal dhe kombëtar.

3. A është e mundur që projekti të ketë edhe një pjesë të kostove nga një palë tjetër?

Jo nuk është e mundur, në të kundërt i gjithë projekti mund të bëhet me fondet e tjera. Bashkëpunimi me projektet e tjera është diçka që i përket çdo organizate, por në rastin e kësaj thirrje projekti juaj duhet të funksionoj si një projekt i vetëm.

4. Kur pritet të fillojë zbatimin i projekteve?

Projektet fituese mund të fillojnë zbatimin e tyre menjëherë pas finalizimit të kontratave brenda fundit të muajit korrik, pra duke filluar nga muaji gusht e deri në kohëzgjatjen e përcaktuar.

5. A mund të punohet për ndryshim politikash vetëm për një bashki apo duhet të punohet vetëm në nivel qendror?

Padyshim ju mund të fokusoheni në ndikim të politikave lokale. Si pjesë e kësaj thirrje inkurajojmë nisma të cilat mund të kenë ndikim edhe për një bashki tjetër. Në rast të ndikimit të një politike lokale duhet të justifikohet koha dhe burimet për të arritur në miratim në nivel bashkiak dhe të jetë një çështje që nëse një bashki tjetër ka po të njëjtin shqetësim të aplikojë të njëjtën qasje. Në mënyrë që qasja të mos mbetet e izoluar në nivelin vendor, nisma mund të jetë një iniciativë me rëndësi për disa bashki në Shqipëri.

6. A mund një OJF të bashkëpunojë me një individ apo duhet patjetër me OJF apo institucion tjetër?

Në rast se individi përfshihet në projekt si ekspert atëherë duhet të ketë një kontratë shërbimi ndërsa kur personin është përfaqësues i një grupi apo unioni atëherë mund të jetë në formë partneriteti prej fazës së aplikimit.

7. A është një tematikë e caktuar më prioritare se sa një tematikë tjetër?

Në pikën 1.2 "Objektivat e thirrjes" janë të detajuara të gjitha fushat prioritare për të cilat mirëpresim projekt propozime.

8. A duhet t'i përmbahemi detyrimisht kriterëve teknike dhe a pranohen aplikimet nëse shkojnë përtej tyre?

Po, të gjitha kriteret e cekura në dokumentin e thirrjes për projekt propozime duhet të zbatohen, në mënyrë që ato të merren në konsideratë, pasi janë kriterë përcaktuar edhe nga Bashkimi Evropian.

9. A duhet patjetër të kemi disa objektiva specifike?

Në një projekt me buxhet të vogël, siç janë këto që mbështeten në kuadër të kësaj thirrje, nuk është e rëndësishme të keni disa objektiva specifike. Projekt propozimi mund të ketë vetëm një objektiv specifik, pasi nëse ka më shumë se dy objektiva specifike ato mund të kalojnë në nivel aktivitetesh ose të shkojnë përtej një projekti.

10. Cili është dallimi mes grupit të interesit dhe grupit të mandatuar?

Ato mund të jenë të njëjtë, pra një grup interesi në të njëjtën kohë edhe mandaton për kryerjen e një initiative, por mund të jenë të ndryshëm sepse grupi mandatues mund të përfshihet në nëngrupime që janë brenda grupit të interesit.

11. Nëse projekti përfshin disa aktorë ku duhet të afrohet asistencë, a e cenon kjo legjitimitetin e projektit?

Jo nuk e cenon pasi procesi i asistencës, ngritja e kapaciteve dhe ndërgjegjësimi do të ndodhin gjatë tërë procesit të ndikimi në politikbërje dhe nuk mund të anashkalohen. Megjithatë, qëllimi kryesor i projekt propozimit nuk duhet të jetë asistenca dhe nuk duhet të synohet ajo. Projekt propozimi duhet të ketë në fokus dialogun, i cili ka disa instrumente advokimi, për të ndikuar një politik të caktuar lokale apo kombëtare.

12. A mund të dështojë projekti?

Gjatë zbatimit të projektit influencimi dhe diskutimet duhet të jenë pjesë e përpjekjes së një veprimi që të japin rezultate pozitive. Nëse miratimi i çështjes nuk arrihet ashtu siç dëshirohet, kjo nuk do të thotë që projekti ka dështuar, pasi vendim-marrja nuk është kompetencë e palës zbatuese të projektit, por e autoriteteve vendim-marrëse.

13. A do të financohej një projekt i cili synon zhvillimin e intervistave në terren me synim daljen në një dokument mbi situatën dhe prezantimin e tij në Këshillin Bashkiak.

Jo, intervistimi nuk mund të jetë qëllimi kryesor i projektit. Në seksionin 2.1.2 shpjegohen shumë shembuj aktiviteteve të cilat mund të mbështeten financiarisht në kuadër të kësaj thirrjeje. Intervistat mund të jenë pjesë e aktiviteteve të projekt propozimeve vetëm nëse ato shërbejnë për të mbledhur të dhëna të cilat do të përdoren për procesin e lobimit dhe futjen në agjendë të një çështje, por intervistat nuk duhet të shërbejnë për krijimin e një dokumenti. Çdo grumbullim informacioni në terren bëhet me qëllim që të shkoj drejt realizimit dhe jo të zbuloj problemin, pasi ju duhet të jetë i identifikuar që në fillim të shkrimit të projekt propozimit.